



Datë: 01.04.2025  
Numër Protokolli: 2271/2025

A.nr.245/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.245/2025 të datës 30.01.2025 të parashtruar nga ankuesja A.L., kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.04.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.245/2025, e datës 30.01.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.L.

**II. Mbetet në fuqi** Njoftimi i datës 28.01.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me anulimin e procedurës së pranimit më numër të referencës RN00016007.

## A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, A.L. (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesja), më datë 30.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016007, gjegjësisht për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore*, i shpallur më datë 10.12.2024 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa,

kjo e fundit, më datë 14.03.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1623/2025 të datës 12.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova:*** Ankesën me numër protokolli 664/2024, të parashtruar nga ankuesja më datë 30.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi i ankueses; Konkursin me numër reference RN00016007, të datës 10.12.2024; Njoftimin e datës 20.01.2025; Listën përfundimtare të vlerësimit të datës 28.01.2025; Konkursin me numër reference RN00014963; Njoftimin e datës 18.10.2024; Listën përfundimtare të datës 12.11.2024; Njoftimin e datës 10.10.2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 14.03.2024; Kërkesën për plotësimin e vendeve të lira të punës të datës 10.12.2024; Vendimin për themelimin e Komisionit të pranimit me numër protokolli 216/2025 të datës 21.01.2025; Akt emërimit me Nr.39/2024 të datës 01.04.2024; Akt emërimit me Nr.36/2024 të datës 01.04.2024; Akt emërimit me Nr.109/2024 të datës 01.04.2024; Akt emërimit me Nr.125/2024 të datës 01.04.2024; Akt emërimit me Nr.1970/2024 të datës 30.09.2024; Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 20.01.2025; Aplikacionin e datës 26.12.2024, të ankueses së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e pabazuar, ***sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 10.12.2024, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00016007, Grupi i Ekonomisë, gjegjësisht për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore*, me afat aplikimi nga data 10.12.2024 deri më datën 09.01.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar 64 kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja, mirëpo prej tyre vetëm 15 kandidatë e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa Divizioni i Burimeve Njerëzore sipas Njoftimit të datës 20.01.2025, ankueses i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se Diploma e bashkangjitura nga ana e saj nuk përkon me Grupin e Ekonomisë dhe si rrjedhojë nuk mjafton për të kaluar verifikimin paraprak.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 28.01.2025, ka publikuar Njoftimin, nga i cili rezulton se procedura e rekrutimit me numër reference RN00016007, për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore*, është anuluar, pasi që asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur pragun e kalueshmërisë në testin me shkrim.

Ankuesja, ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se organi i përkatës i punësimit nuk ka zbatuar drejtë ligjin material duke i refuzuar aplikacionin, duke theksuar ndër të tjera se për Grupin e Ekonomisë nuk janë vendosur kritere specifike

dhe se po ashtu me të njëjtën diplomë ka aplikuar për pozitën e nivelit të ulët drejtues të shpallura nga MFPT, andaj e njëjta pretendon se pa të drejtë i është pamundësuar ushtrimi i të drejtës së barabartë për të konkurruar.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen Konkursit publik me numër reference RN00016007, respektivisht për pozitën e punës *“Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore”*-Grupi i Ekonomisë, Profesional 1, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë, **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 2 (dy) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji i Këshillit, përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses, mori për bazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës I të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës VI të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 10.12.2024.

Duke marrë për bazë Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, të aprovuar sipas Vendimit Nr.08/226 të datës 23.10.2024, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita *“Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore”*, Klasa Profesional 1, identifikohet me kodin SHC-00542 në kuadër të **Grupimit të Shkencave Shoqërore**, kurse fushat e kërkuara të arsimit për këtë pozitë pune janë përcaktuar këto: **Juridik, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike.**

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e aplikuar të nenit 19, nenit 20 si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: **“19. Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi; 20.1 . Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 20.2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për pozitën përkatëse. 30.1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 30.2. Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe**

***kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.***”, konstatoi se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve shpalljen e konkursit RN00016007 të datës 10.12.2024 për pozitën “Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore” e kanë shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hy në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimin Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, pasi që pozita e shpallur hynë në kuadër të grupimit **Grupin e Shkencave Shoqërore**, ndërsa sipas konkursit është përfshirë në grupin **Grupi e Ekonomisë**, dhe për rrjedhojë pozitës në fjalë i janë ndryshuar edhe kriteret e përcaktuara të kualifikimit arsimor të cilat janë të përcaktuara sipas rregullores së lartcekur dhe Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, në atë mënyrë që nuk është përcaktuar ndonjë fushë arsimit, mirëpo vetëm diplomë e arsimit të lartë të nivelit të parë (Bachelor), ndërsa ankueses e cila sipas aplikacionit të sat punësimi të datës 26.12.2024, rezulton se posedon Diplomën me Nr.D-07/14 të lëshuar më datë 15.01.2015 nga Kolegji ISPE, për studimet themelore të kryera më datë 31.07.2017 në Programin e Studimeve të Integruara Evropiane, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se diploma e ankueses nuk përkon me Grupin e Ekonomisë.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të rekrutimit shkeljet janë evidentuar që nga shpallja e konkursit të datës 10.12.2024, ashtu që nuk janë përfillur kriteret e aprovuara lidhur me grupimin e pozitës, duke ndryshuar më pastaj edhe kriteret për fushën e kualifikimit arsimor për pozitën *Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndhmës Shtetërore*, dhe pasi që procedura e rekrutimit me numër reference RN00016007, sipas Njoftimit të datës 28.01.2025, të Divizioni të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ka përfunduar/është anuluar, pasi që asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur pragun e kalueshmërisë në testin me shkrim, Kolegji i Këshillit, nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankueses të parashtruara si në ankesën e datës 30.01.2025 lidhur me refuzimin e aplikacionit të saj, pasi që për shkak të pa ligjshmërive të lartë theksuara, konstatimi nëse pretendimet e ankueses janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankueses është refuzuar vetëm për arsytet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.245/2025**

**Atdhe GASHI**

---

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

---

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses A.L.;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.